

# AKTIVITETET KRYESORE TË ADMINISTRATËS DOGANORE SHQIPTARE

## MARS 2024



### DREJTORI I DOGANAVE, GENTI GAZHELI, TAKON DREJTORIN E SELEC, OĞUZ SERKANT AKIN

Drejtoria e Përgjithshme të Doganave, Genti Gazheli, zhvilloi një takim me Drejtorin e Përgjithshëm të Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Europën Juglindore (SELEC), Oğuz Serkant Akin. Në fokus të këtij takimi ishte bashkëpunimi i mëtejshëm i Administratës Doganore Shqiptare me organizatën ligjzbatuese SELEC, në kuadër të luftës kundër krimit të organizuar ndërkufitar, si dhe në drejtim të shkëmbimit të informacionit dhe inteligjencës kriminale.

### DREJTORI I DOGANAVE, GENTI GAZHELI, PRET DREJTORIN E PËRGJITHSHËM PËR ZBATIMIN E EMIGRACIONIT NË MINISTRINË E BRENDSHME BRITANIKE, BAS JAVID

Drejtoria e Përgjithshme të Doganave, Genti Gazheli, priti Drejtorin e Përgjithshëm për Zbatimin e Emigracionit në Ministrinë e Brendshme britanike, Bas Javid. Në takim u diskutua mbi masat e ndërmarra nga Shqipëria në luftën kundër trafiqeve e kontrabandës dhe mbështetjen nga Mbretëria e Bashkuar ndaj Shqipërisë.



### DREJTORI I PËRGJITHSHËM I DOGANAVE TAKOHET ME DREJTUES TË UNCTAD

Drejtoria e Përgjithshme të Doganave, Genti Gazheli, zhvilloi një takim me drejtues të Programit Asycuda të UNCTAD. Z. Gazheli, shprehu vullnetin e Administratës Doganore Shqiptare për zhvillime të reja, të vazhdueshme dhe të qëndrueshme të sistemit informatik doganor në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian që përfshijnë tranzitin, vendimet doganore, deklarimin e thjeshtuar. Drejtuesit e UNCTAD shprehën gatishmërinë dhe vullnetin në mbështetje të kërkesave të ADSh me qëllim modernizimin e sistemit informatik doganor në përputhje me standardet e BE-së.



### BLLOKOHEN NË DOGANËN E KAPSHTICËS 45 STEKA ME CIGARE PA PULLË FISKALE

Pas kontrollit të ushtruar nga autoritetet doganore, në bashkëpunim edhe me strukturat e Policisë së Shtetit, është bërë sekuestrimi i 45 stekave me cigare kontrabandë dhe bazuar në dispozitat e Ligjit 102 të "Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë", subjektit i është vendosur një masë administrative gjorbë, në masën 422.415 lekë.



### SEKUESTROHEN LËNDË NARKOTIKE TË DËRGUARA ME POSTË NGA SHBA

Specialistët për Hetimin e Narkotikëve, në bashkëpunim me Drejtorinë e Hetimit Doganor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave kanë finalizuar operacionin policor të koduar "Atlanta". Si rezultat i këtij operacioni u godit një rast i trafikimit të lëndëve narkotike nga ShBA në Shqipëri, ndërsa u sekuestruan 1 kg e 600 gramë cannabis sativa, me përqindje të lartë THC.



### DOGANA DIGJITALE

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave i është bashkuar nismës së Qeverisë për të digjitalizuar shërbimet për qytetarët dhe bizneset, nëpërmjet platformës E-Albania. Digjitalizimi i sistemit doganor ka bërë që të krijohen lehtësi për biznesin, shkurtim të kohës procedurale, rritje e transparencës dhe ulje e nivelit të korrupsionit. Vetëm gjatë muajit Mars 2024 nga Administrata Doganore Shqiptare janë miratuar 640 shërbime online.



### HETIMI DOGANOR TJETËR GODITJE TRAFIKUT TË LËNDËVE NARKOTIKE PËRMES POSTËS

Drejtoria e Hetimit Doganor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave në bashkëpunim me Seksionin për Hetimin e Narkotikëve kanë finalizuar gjatë muajit mars edhe operacionin e koduar "California". Si rezultat i tij u godit një tjetër rast i trafikimit të lëndëve narkotike nga ShBA në Shqipëri, me anë të shërbimit postar dhe u sekuestruan 3 kg e 200 gramë cannabis sativa, me përqindje të lartë THC e ndarë në pako, shuma parash dhe celularë.



### A E DINI SE ?



- Të gjithë personat të cilët hyjnë ose largohen nga territori i Republikës së Shqipërisë, janë të detyruar të deklarojnë shumat në të holla, si çdo lloj instrumenti të negociueshëm të mbajtësit,
- Metalet ose gurët e çmuar
- Sendet me vlerë
- Objektet antike

duke filluar nga shuma 10 000 euro, ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera, qëllimin e mbajtjes së tyre, si dhe të paraqesë dokumente justifikuese përkatëse.

- Deklarimi kryhet pranë zyrave të Administratës Doganore, në Pikën e Kalimit Kufitar, hyrje apo dalje nëpërmjet formularit për raportimin e transportit të vlerave në kufi (RTVK) i cili plotësohet online pranë zyrave doganore në Pikat e Kalimit Kufitar.